VENDIM
Nr.51, datë 3.7.2009

PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN NR.29, DATË 16.4.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2009 PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe nenit 129 të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.7.2009, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për korrigjimin e vendimin nr.29, datë 16.4.2009 "Për përcaktimin e pagesave të rregullimit, për vitin 2009, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike" të Bordit të Komisionerëve dhe konsideroi të drejtë atë,

VENDOSI:

1. Korrigjimin e pagesës së rregullimit të shoqërisë "Juana" sh.p.k., për vitin 2009, si më poshtë:

- Shifra "25 000", e përcaktuar në tabelën përfundimtare të pagesave të rregullimit, do të bëhet "2 500".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta